VENDIM
Nr.212, datë 18.4.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.185, DATË 29.3.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LEJIMIN E NDËRMARRJES "MEICO" TË MINISTRISË SË MBROJTJES, TË PËRDORË PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË", PËR RIPARIMIN E HELIKOPTERËVE BO 105 M VBH, TË DHURUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE PËR SIGURIMIN E PJESËVE TË KËMBIMIT PËR KËTA HELIKOPTERË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.185, datë 29.3.2006 të Këshillit të Ministrave, tabela "Pagesa e institucioneve, që do të kryhen për ndërmarrjen "Meico"", të zëvendësohet me tabelën me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGESAT E INSTITUCIONEVE QE DO TE KRYHEN PER NDERMARRJEN "MEICO"

Ne Milion leke

Nr.	Emertimi	Viti 2006				Viti 2007				Viti 2008				TOTALI		
		Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat	
			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231
a	*b*	*1*	*2*	*3*	*4*	*5*	*6*	*7*	*8*	*9*	*10*	*11*	*12*	*13*	*14*	*15*
1	Ministria e Mbrojtjes	369.677	311.105	58.572	Brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kontrates	468.274	430.693	37.581	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	144.386	119.852	24.534	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	982.337	861.650	120.687
2	Ministria e Brendshme	86.341	78.691	7.650	Brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kontrates	0.000	0.00	0.00	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	256.891	256.891	0.000	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	343.232	335.582	7.650
3	Ministria e Shendetesise	1.428	1.428	0.000	Brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kontrates	0.000	0.00	0.00	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	0.000	0.000	0.000	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	1.428	1.428	0.000
	TOTALI	**457.446**	**391.224**	**66.222**		**468.274**	**430.693**	**37.581**		**401.277**	**376.743**	**24.534**		**1326.997**	**1198.660**	**128.337**